

"Zëri", 29/07/2011

Austria shtyn përpara arsimin e lartë

Anita Kadriu

PRISHTINË. Me mbështetjen e qeverisë austriake reformat në Universitetin e Prishtinës (UP) kanë treguar rezultate drejt përsosjes së metodologjive të mësimdhënies, infrastrukturës, zbatimit të lëndëve të reja mësimore, programe të reja në nivelin master si dhe profesionalizmit të mësimdhënësve në fusha të ndryshme. Ky ka qenë konstatimi i krerëve të UP-së, përfaqësuesve të qeverisë austriake si dhe organizatës për ndihmë arsimi "Wus Austria", në ceremoninë përmbylëse të projektit "Mbështetja e reformave në arsimin e lartë në Kosovë 2008-2011", të financuar nga Agjencia Austriake e Zhvillimit-ADC dhe të implementuar nga Wus Austria në UP. Gjatë kësaj periudhe implementuese, programi ka qenë i fokusuar në lidhjen e arsimit të lartë me tregun e punës. Udhëheqësi i WUS Austria në Kosovë, But Dedaj, ka



NDËRTIMI I KAPACITETEVE

Udhëheqësi i WUS Austria në Kosovë, But Dedaj, ka thënë se kujdes i veçantë i është kushtuar ndërtimit të kapaciteteve institucionale dhe njerëzore në UP.

thënë se kujdes i veçantë i është kushtuar ndërtimit të kapaciteteve institucionale dhe njerëzore në UP.

Për sa i përket përmbajtjes, ai ka theksuar se programi ka pasur për qëllim të mbështesë integrimin e Kosovës në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë, duke kontribuar kështu në zhvillimin ekonomik të Kosovës të bazuar në dije. Ky projekt, sipas Dedajt, është përbërë nga katër programe, si: programi për zhvillimin e studimeve master, zhvillimin e plan-programeve, për kthimin e trurit dhe mbështetje për zyrën për zhvillim akademik - njësia e kurrikulës.

Ndërkaq, rektori i UP-së, Mujë Rugova, ka vlerësuar se mbështetja shumëvjeçare e qeverisë austriake dhënë UP-së, ka pasur rëndësi të madhe për ngritjen e cilësisë së studimeve në këtë fakultet, përmes shumë projekteve. Zbatimi i projektit për mbështetje të reformave është cilësuar i suksesshëm edhe nga ambasadori i Austrisë në Kosovë, Johann Brieger.

Në fund të ceremonisë rektori Rugova ka ndarë mirënjohje për përfaqësuesin austriak të programit, Christian Geosits, dhe udhëheqësin e Wus Austria, But Dedaj. Ndërsa, WUS Austria ka ndarë tre çmime për zbatimin e programeve më të mira. Çmimi i parë i ka takuar profesorit të juridikut, Visar Morina, me shpërblim prej 1000 euro, i dyti profesorit Naser Zabeli me 700 euro dhe në vendin e tretë profesoresha Linda Grapci me 500 euro.